



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 3829 Prot.

Fier, më 25.03.2026

Projekt - Vendim

Nr. 31 dt. 25.03.2026

“Për dhënien e miratimit për nxjerrjen nga inventari të aktiveve, pasurisë të llojit “ndërtesë” (Ilogaria ekonomike 212) e Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Fier”

Këshillit të Bashkisë Fier sot më datë ____ .03.2026, i paraqitet për shqyrtim projekt vendimi, bazuar në nenin 54, shkronja “e/1 dhe k” të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 12 pika “f” e ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 mbi “Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 915 datë 11.11.2015 "Për transferimin në pronesi nga Këshillat e Qarqeve të Bashkive, të rrejtit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, shkresë nr. 99 prot. dt. 25.02.2026 me lëndë “Kërkesë për miratim për dalje jashtë përdorimit të aktiveve Ilogaria ekonomike 212” protokolluar në Bashki me nr. 2582 prot. dt. 25.02.2026, **Kryetari i Bashkisë;**

Propozon:

1. Dhënien e miratimit për nxjerrjen nga inventari të aktiveve, pasurisë të llojit “ndërtesë” (Ilogaria ekonomike 212) e Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit”, pasuri në të cilën është ndërtuar Stacioni Zjarrfikës, Bashkia Fier.
2. Ngarkohet ekzekutivi për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore për nxjerrjen nga inventari të kësaj pasurie, sipas përcaktimeve ligjore.

Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit

Drejtores: E. Kola

Drejtorja e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit

Drejtores: P. Çina

Drejtorja Juridike

Drejtores: E. Kapllanaj

Drejtorja e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave

Konc. M. Petushi

KRYETARI
Armando SUBASHI

